



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

**KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;  
Dhe

**KONTRAKTORI "MENTI" Shpk Komuna e Istogut**, të cilën e përfaqëson z. Islam Shoshi, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810298556 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

### TITULLI I KONTRATËS:

#### **ASFALTIMI I RRUGËS NE LLUKAVC TE BEGUT**

<i>Nr. I prokurimit</i>	633-20-5365 - 5-2-1/ C 406
<i>Nr. I brendshëm</i>	633 / 020 / 086 / 521

### **Neni 1 Lënda**

**1.1** Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

#### **ASFALTIMI I RRUGËS NË LLUKAVC TE BEGUT**

**2.1** Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit: **ASFALLTIMI I RRUGËS NË LLUKAVC TE BEGUT është: 68.519,65 € dhe me fjalë: Gjashtëdhjetëtetë mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë euro-65/100 €**

**2.2** Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

**2.3** Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:**

#### **3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:**

*Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralloqaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës*

*3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

### **Neni 4. Afati i përmbushjes së kontratës:**

*4.1 Kontrata do të fillonë te realizohet ne momentin e nënshkrimit të sajë dhe do te përmbushet ne afat prej 30 ditësh, nga data e nënshkrimit te se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 21.12.2020*

*4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të përgjigjet per demet eventuale qe mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.*

### **Neni 5 Komunikimet**

*5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

*5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për*


*pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.*

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për: Autoritetin Kontraktues:  
KOMUNA E ISTOGUT**

**Për: Kontraktuesin:  
"MENTI" Shpk**

<b>Emri:</b>	<b>Gëzim Ademaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>Islam Shoshi</b>
<b>Pozita:</b>	<b>U.D. I Menaxheri-t të Prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>D r e j t o r</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>12.11.2020</b>	<b>Data:</b>	<b>12.11.2020</b>
<b>Vu la</b>		<b>Vu la</b>	

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbuloohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë;gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës se kontratës me vlefshmëri 60 dite.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 30 dite.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është përgjegjës per realizimin e punimeve sipas përshkrimi ,kualiteti dhe kuantiteti.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.  Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë <u>17</u> .

# PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE

## Asfaltimi I rrugës në Llukac të Begut

KRAHU 01

Nr. rend or	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
<b>1 PUNËT PARAPRAKE</b>					
1.1	Shënimi i trases para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit dhe pas përfundimit të punimeve për prezantimin e masave të sakta të ekzekutuara.	m'	520.00	0.40	208.00
1.2	Pastrimi i trases nga shkurret, nga drunjet me diametër deri Ø50cm, Demolimi i mureve nga tullat dhe prej guri, demolimi i rrethojave metalike, transportimi i tyre deri në deponinë në largësi 10km. Në rastet specifike (me urdher të investitorit apo organit mbikqyrës) rrethojat gjembore-metalike të rivendosen në pozita të reja pas kryerjes së punimeve.	m'	520.00	0.50	260.00
1.3	hapje e kanaleve për ujë atmosferik	m'	850.00	0.50	425.00
1.4	Demolimi i pusëve ekzistuese me ngarkim dhe bartje deri në deponi max 15km. Në cmim të parashihet edhe ngritja e tyre me konuse si dhe vendosja e kapakeve nga materiali kompozit (konform standartet e Europjane-Env) 40t me kurore prej betoni të armuar t=20cm.	copë	10.00	120.00	1,200.00
1.5	Shqyrtimi i të gjitha prova për të gjitha shtresat e rrugës në laborator sipas kërkesës së investitorit (Nën bazës, shtresës stabilizuese, Tampon 0-63, Tamponit 0-30, Dy shtresave të asfaltit etj..)	m'	520.00	0.20	104.00
<b>PUNËT PARAPRAKE Gjithsej:</b>					<b>2,197.00</b>

## 2 PUNIMET E DHEUT

2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së II-IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min. 10km. Në vëllim është përfshirë edhe punimi dhe formësimi i kanaleve kulluese të rrugës	m <sup>3</sup>	1,700.00	1.50	2,550.00
2.2	Rrafshimi i nënbasës me ngjeshje me vibrocilinder deri në 30 MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	3,120.00	0.20	624.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i bankinave me gjerësi 0.75m me material të granular 0-31 mm	m <sup>3</sup>	336.00	6.00	2,016.00
<b>PUNIMET E DHEUT Gjithsej:</b>					<b>5,190.00</b>

	<b>Lëshesat gypore, ujmbledhësat, rigollat , pahi elastike dhe muret mbrojtëse</b>				
3.1	Gërmimi i dheut i kategorisë II-IV-të për themele me ngarkim dhe bartje në deponi në largësi 2 km	m <sup>3</sup>	265.00	1.50	397.50
3.2	Punimi i lëshesës gypore me : Furnizimi ,bartja dhe montim të gypave të armuar (Q-188) nga betoni të vendosur në shtresë tamponi me punim të bredhit ,kokave të lëshesave ose parapeteve me C-30/37 dhe kalldermes me gure të vendosur në shtresë prej rere me mbushje të fugave me llaq qimentoje				-
	Ø630 gypa polietileni HDPE SN8 me koka betoni	m'	24.00	20.00	480.00
	Ø600 gypa betoni me koka betoni	m'	15.00	20.00	300.00
<b>OBJEKTET Gjithsej:</b>					<b>1,177.50</b>

#### 4 MBISTRUKTURA

4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbushjes (60MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-150mm me trashësi t~50cm (variabile në vende të caktuara) të shtesuar në shtresë max.30cm	m <sup>3</sup>	1,560.00	3.00	4,680.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm	m <sup>3</sup>	780.00	5.00	3,900.00

4.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31mm me trashësi t=15cm	m <sup>3</sup>	450.00	6.00	2,700.00
4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltbetonit 0-16mm ,t=7cm	m <sup>2</sup>	2,100.00	6.00	12,600.00
<b>MBISTRUKTURA Gjithsej:</b>					<b>23,880.00</b>
<b>REKAPITULLIMI PËR KRAHUN 01</b>					
<b>1</b>	<b>PUNËT PARAPRAKE</b>				2,197.00
<b>2</b>	<b>PUNIMET E DHEUT</b>				5,190.00
<b>3</b>	<b>OBJEKTET</b>				1,177.50
<b>4</b>	<b>MBISTRUKTURA</b>				23,880.00
<b>TOTALI</b>					<b>32,444.50</b>

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE**  
**Asfaltimi I rruges Ilukafc**  
**KRAHU 02**

Nr. rendor	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
------------	---------------	--------	-------	--------------------	--------------------

**1 PUNËT PARAPRAKE**

1.1	Shënimi i trases para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit dhe pas perfundimit te punimeve per prezentimin e masave te sakta te ekzekutuara.	m'	580.00	0.40	232.00
1.2	Pastrimi i trases nga shkurret, nga drunjet me diameter deri Ø50cm, Demolimi i mureve nga tullat dhe prej guri, demolimi i rrethojave metalike, transportimi i tyre deri ne deponinë në largësi 10km. Në raste specifike (me urdher te investitorit apo organit mbikqyrës) rrethojat gjembore-metalike te rivendosen në pozita te reja pas kryerjes se punimeve.	m'	580.00	0.50	290.00
1.3	hapje e kanaleve per ujra nentoksore	m'	850.00	0.50	425.00
1.4	Demolimi i pusetave ekzistuese me ngarkim dhe bartje deri ne deponi max 15km. Ne cmim te parashihet edhe ngritja e tyre me konuse si dhe vendosja e kapakeve nga materiali kompozit(konform standarteve Europjane-Env) 40t me kurore prej betoni te armuar t=20cm.	copë	1.00	120.00	120.00
1.5	Shqyrtimi I të gjitha prova per te gjitha shtresat e rruges ne laborator sipas kerkeses se investitorit(Nenbazes,shtreses stabilizuese, Tampon 0-63, Tamponit 0-30, Dy shtresave te asfaltit etj..)	m'	580.00	0.20	116.00
<b>PUNËT PARAPRAKE</b>				<b>Gjithsej:</b>	<b>1,183.00</b>

**2 PUNIMET E DHEUT**

2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së II-IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min. 10km. Në vëllim është përfshire edhe punimi dhe formësimi I kanaleve kulluese të rrugës	m <sup>3</sup>	1,160.00	1.50	1,740.00
-----	---	----------------	----------	------	----------

2.2	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje me vibrocilinder deri në 30 MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	2,320.00	0.20	464.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i bankinave me ngjeshje me trashësi t=10cm dhe gjerësi 0.5m me material te granular 0-31 mm	m <sup>3</sup>	116.00	6.00	696.00
<b>PUNIMET E DHEUT</b>			<b>Gjithsej:</b>		<b>2,900.00</b>

### 3 OBJEKTET

<b>Lëshesat gypore, ujmbledhësat, rigollat , pahi elastike dhe muret mbrojtëse</b>					
3.1	Gërmimi i dheut i kategorisë II-IV-të për themele me ngarkim dhe bartje në deponi në largësi 2 km	m <sup>3</sup>	1,160.00	1.50	1,740.00
3.2	Punimi i lëshesës gypore me : Furnizimi ,bartja dhe montim te gypave te armuar (Q-188) nga betoni te vendosure ne shtrese tamponi me punim te bredhit ,kokave te leshesave ose parapeteve me C-30/37 dhe kalldermes me gure te vendosur ne shtres prej rere me mbushje te fugave me llaq qimentoje				
	Ø400 gypa polietileni HDPE SN8 me koka betoni	m'	30.00	12.00	360.00
	Ø600 gypa betoni me koka betoni	m'	20.00	20.00	400.00
<b>OBJEKTET</b>			<b>Gjithsej:</b>		<b>2,500.00</b>

### 4 MBISTRUKTURA

4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbushjes (60MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-150mm me trashës t~50cm (variable ne vende te caktuara) te shtesuara ne shtresa max.30cm	m <sup>3</sup>	1,160.00	3.00	3,480.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm	m <sup>3</sup>	580.00	5.00	2,900.00
4.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31mm me trashësi t=15cm	m <sup>3</sup>	350.00	6.00	2,100.00
4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltbetonit 0-16mm ,t=7cm .	m <sup>2</sup>	1,760.00	6.00	10,560.00
<b>MBISTRUKTURA</b>			<b>Gjithsej:</b>		<b>19,040.00</b>

#### REKAPITULLIMI PËR KRAHUN 02

1	<b>PUNËT PARAPRAKE</b>	1,183.00
2	<b>PUNIMET E DHEUT</b>	2,900.00
3	<b>OBJEKTET</b>	2,500.00
4	<b>MBISTRUKTURA</b>	19,040.00
<b>TOTALI</b>		<b>25,623.00</b>

#### REKAPITULLIMI TOTAL

1	<b>KRAHU 01</b>	32,444.50
2	<b>KRAHU 02</b>	25,623.00
<b>TOTALI</b>		<b>58,067.50</b>
<b>TVSH</b>		<b>10,452.15</b>
<b>TOTALI + TVSH</b>		<b>68,519.65</b>